

22 tetor 2025,
Prishtinë

Komisioni i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të FBK-së, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e mbajtur me datë 21.10.2025, në përbërje prej: Armend Hamiti kryetar i KG, Arianit Shala anëtar i KG dhe Ismet Ferati anëtar i KG shqyrtoi dhe miratoi këtë:

VENDIM NR.06/ 2025-26 I KOMISIONIT TË GARAVE

- I. Komisioni i Garave ka shqyrtuar kërkesën e paraqitura nga KBF RBAU21 për regjistrimin e lojtares se Huaj Diane Marie Hurst për edicionin 2025/26 .
- II. Lidhur me këtë çështje nga Propozicionet e garave gjegjësisht neni 13.13 i PG: “Ekipet e Ligës Zhvillimore për Vajzat U21 kanë të drejtë të kenë këtë përbërje: 2 lojtare mbi moshën 21 vjeçare, 2 lojtare me licencë të dyfishtë, dhe lojtaret e tjera duhet të jenë nën moshën 21.”
Neni 13.15.2 i PG parasheh pagesa për LOC vetëm për Superligën Femrat¹:
Kurse Neni 13.19 i PG i parasheh kushtet edhe për Ligen e parë të meshkujve² , por as ky nen apo ndonjë neni i PG nuk e normon në asnjë formë mundësin e paraqitjes se lojtareve te huaja ne Ligen Zhvillimore U21 te Vajzave.
- III. Komisioni i garave pas shqyrtimit të kësaj kërkeje e bazuar në Propozicionet e Garave për kategoritë seniorë Edicioni 2025/2026, REFUZON kërkesën e KBF RBA për regjistrimin e lojtares se huaj Diane Marie Hurst për edicionin 2025/26 .
- IV. Vendimi hyn në fuqi nga data e publikimit.

¹ Ekipet e Superligës Femrat do të paguajnë shumën prej 250.00€ për secilën prej katër lojtareve të para të huaja të regjistruara me kalim nga klubi në klub apo kërkesë për LOC; shumën prej 500.00€ për lojtaren e pestë dhe të gjashtë të regjistruar; shumën prej 2,500.00€ për lojtaren e shtatë dhe të tetë të regjistruar; shumën prej 5,000€ për lojtaren e nëntë dhe të dhjetë të regjistruar; dhe shumën prej 10,000.00€ për të gjitha lojtaret shtesë të regjistruara përtej kësaj shifre (11 e tutje).

² Në Ligën e Parë Meshkujt, ekipet kanë të drejtë të regjistrojnë 1 (një) lojtar të huaj, nën kushtet e parapara për Superligën Femrat. Afati i fundit për paraqitjen e lojtarëve të huaj është 72 orë para fillimit të xhiros së ciklit të fundit garues të stinorit aktual.

ARSYETIM

Gjatë vendimmarrjes lidhur me pikën I të Vendimit Nr.06/2025-26, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

- (a) KBF RBAU21 ka paraqitur për regjistrim lojtaren e huaj Diane Marie Hurst për edicionin 2025/26.
- (b) Komisioni i garave Komisioni i Garave, duke u bazuar në **Propozicionet e Garave për kategoritë seniore – Edicioni 2025/2026**, vlerëson se **Neni 13.13 është i qartë dhe i mjaftueshëm në përcaktimin e strukturës së lejueshme të ekipit në Ligën Zhvillimore për Vajzat U21**, duke lejuar: Deri në dy (2) lojtare mbi moshën 21 vjeç; Deri në dy (2) lojtare me licencë të dyfishtë; Dhe pjesa tjetër e lojtareve nën moshën 21 vjeç.
- (c) Në këtë dispozitë **nuk parashihet në asnjë formë lejimi i lojtareve të huaja**, dhe po ashtu, në Propozicionet e Garave **nuk ekziston ndonjë dispozitë e veçantë e ngjashme me Nenin 13.19**, i cili në mënyrë të qartë **autorizon Ligën e Parë të Meshkujve** që të aplikojë kushtet e Superligës së Femrave për regjistrimin e një lojtari të huaj (duke përfshirë edhe pagesat për LOC).
- (d) Prandaj, Komisioni i Grave vlerëson se **nuk mund të aplikohet analogjia ligjore**, pasi sipas parimeve të interpretimit juridik, veçanërisht në fushën e të drejtës sportive, **çdo përjashtim nga rregullat standarde kërkon një bazë të qartë dhe specifike ligjore**. Po ashtu, **pagesat për LOC dhe regjistrimi i lojtareve të huaja nuk mund të zbatohen në këtë ligë**, në mungesë të një autorizimi të drejtpërdrejtë në **Propozicionet e Garave**.

(e) Andaj, Komisioni i Garave ne përputhje me Propozicionet e Garave për kategoritë seniore Edicioni 2025/2026, merr vendimin për të refuzuar kërkesën e paraqitur nga KBF RBAU21, që ka të bëjë me regjistrimin e lojtares së huaj Diane Marie Hurst për edicionin 2025/26, në kuadër të Ligës Zhvillimore për Vajzat U21.

Komisioni i Garave:



Arianit Shala

Anëtar



Armend Hamiti

Kryetar



Ismet Ferati

Anëtar

Federata e Basketbollit të Kosovës

Federata e Basketbollit të Kosovës



KËSHILLË JURIDIKE: Në pajtim me Nenin 45 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2025/2026, në vendimin e Komisionit të Garave është e lejuar ankesa tek Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së (si organ i shkallës së dytë), e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit. Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 500.00 €.